Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose ekuivalentet”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

1. Bojë hidroplastike cilësi e lartë

Bojë akrilike për fasadë (*bojë akrilike për lysterje të jashtme.*) Boja duhet të jetë e prodhuar për përdorim të jashtëm me rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Boja do të aplikohet nga kontraktuesi sipas ngjyrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, beton, etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi.

Karakteristikat Teknike:

- | | |
|---------------------------|---|
| - Natyra e lidhësit: | Kopolimer (rezinë) akriliku |
| - Viskoziteti: | 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente |
| - Tharja: | ≤ 5 orë |
| - Norma e hapjes: | ≥ 15 m ² /litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm) |
| - Peshë specifike: | 1.5 ± 0.2 kg/litër |
| - Pamja estetike: | Mat, pa shkëlqim |
| - Ngjyrat në dispozicion: | Sipas kërkesave të AK |

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 25g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.
- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalentin e tij për bojra dhe llaqe, lidhur me rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lysterjes.

2. Astar akrilik

Izolues akrilik i cili të hollohet me ujë dhe të jetë në gjendje për të konsoliduar lidhjen midis shtresave të ndryshme si gips, çimento, suva, beton etj. dhe shtresës së bojës për ambjente të jashtme. Të jetë i lehtë në aplikim dhe të ketë normë të lartë përhapje.

Karakteristikat Teknike:

- | | |
|------------------------|--|
| - Natyra e lidhësit: | Kopolimer (rezinë) akriliku |
| - Viskoziteti: | 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente |
| - Tharja për rilyerje: | ≤ 5 orë |
| - Norma e hapjes: | ≥ 25 m ² / Litër |
| - Peshë specifike: | 1.2 ± 0.2 kg/litër |
| - Pamja estetike: | Transparente |

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 15g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.

3. Bojë hidroplastike

Bojë plastike (bojë plastike për lyerje të brendshme). Boja plastike të jetë cilësore, pa erë që nuk ndikon në përhapjen e zjarrit, të përdoret për ambjente të brendshme dhe të jashtme. Përbëja e saj duhet të jetë me bazë vinilike (PVA polimer) dhe në shpërndarje ujore i jep asaj rezistence optimale ndaj agjenteve të jashtëm. Formula e saj nuk duhet të dëmtojë përdoruesin dhe të jetë e përshtatshme për t’u aplikuar mbi suva, tullë, gips, beton etj. Duhet të ketë aftësi të mira mbuluese.

Karakteristikat teknike:

- | | |
|---------------------------|---|
| - Natyra e lidhësit: | Kopolimer (rezinë) vinilike |
| - Viskoziteti: | 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalent |
| - Tharja: | ≤ 5 orë |
| - Norma e hapjes: | ≥ 15 m ² /litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm) |
| - Peshë specifike: | 1.5 ± 0.2 kg/litër |
| - Pamja estetike: | E lëmuar, mat. |
| - Ngjyrat në dispozicion: | Sipas kërkesave të AK |

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 10g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.

- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalentin e tij për bojra dhe llaqe, lidhur me rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t’u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes.

4. Astar vinilik

Izolues vinilik i cili të hollohet me ujë dhe të jetë në gjendje për të konsoliduar lidhjen midis shtresave të ndryshme si gips, çimento, suva, beton etj. dhe shtresës së bojës për ambjente të brendshme. Të jetë i lehtë në aplikim dhe të ketë normë të lartë përhapje.

Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) vinilike
- Viskoziteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja për rilyerje: ≤ 5 orë
- Norma e hapjes: ≥ 25 m² / Litër
- Pesha specifike: 1.2 ± 0.2 kg/litër
- Pamja estetike: Transparente

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 15 g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kritereve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.

5. Bojë hidromat

Boja hidromat të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) vinilike
- Viskoziteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method)ose ekuivalente
- Tharja: ≤ 5 orë
- Norma e hapjes: ≥ 15 m² / litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm)
- Pesha specifike: 1.5 ± 0.2 kg/litër
- Pamja estetike: Mat
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 10 g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kritereve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.

6. Bojë vaji

Boja të jetë me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë dhe e tretshme në ujë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike dhe druri.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Rezinë Alkide
- Viskoziteti: 120 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja: ≤ 5 orë
- Norma e hapjes: ≥ 10 m² / litër (me një shtresë)
- Pesha specifike: 1.3 ± 0.2 kg/litër
- Pamja estetike: me shkëlqim

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 80 g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kritereve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme”.

7. Bojë betoni

Boja të jetë me polimere akrilike me bazë uji, e cila shërben për përdorim të jashtëm, për sipërfaqe të strukturave të betonit, duke siguruar lidhje të fortë me strukturën e betonit, papërshkueshmëri të ujit, qëndrueshmëri ndaj rrezeve ultraviole dhe erozionit të agjentëve atmosferikë, papërshkueshmëri të gazit CO₂ dhe joneve të klorurit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) akriliku
- Viskoziteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja: ≤ 4 orë
- Norma e hapjes: ≥ 7 m²/litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm)
- Pesha specifike: 1.4 ± 0.2 kg/litër
- Pamja estetike: Mat, pa shkëlqim
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK

8. Bojë bikomponente vijëzimi

Boja të jetë Rezinë Methyl Methacrylate (MMA), e cila shërben për përdorim të jashtëm, në sipërfaqe rrugësh, parkingje, sheshe sportive etj. Kjo lloj rezine është e përshtatshme posaçërisht për të realizuar një tharje sa më të shpejtë për shkak të natyrës së aplikimit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë.

Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit bazë: Rezinë Methyl Methacrylate (MMA)
- Viskoziteti: 120 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja: ≤ 30 min në 25°C
- Pesha specifike: 1.6 ± 0.2 kg/litër
- Tharja: ≤ 30 min në 25°C
- Norma e hapjes: ≥ 1.5 kg/m² (spesor 1mm)
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

Rezultati për identifikimin e përbërësve të lidhësit bazë dhe rezultati për vlerën e peshës specifike duhet të jenë provuar me anë të metodës së testimit në përputhje me Standartin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “*Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodat laboratorike për identifikim*” ose ekuivalentin e tij.

9. Stuko patinimi

Stukoja e patinimit të jetë material i cili realizon një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë.

Karakteristikat teknike:

- Forma: Pluhur
- Pesha specifike: 1.2 ± 0.2 kg/litër
- Rezistenca në ngjeshje: ≥ 4.5 MPa (N/mm²)
- Rezistenca në përkulje: ≥ 1.5 MPa (N/mm²)
- Forca në ngjitje: ≥ 0.8 MPa (N/mm²)
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij. Ky standart është i zbatueshëm për llaçet e fabrikuara të suvatimit dhe stukimit, të bëra në bazë të lidhjeve inorganike për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm në mure, tavane, kolona dhe ndarëse. Ai përmban përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

10. Llaç i gatshëm

Llaçi i gatshëm të jetë i prodhuar për aplikim si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, dhe të jetë i përgatitur në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv. Duhet të ketë cilësinë që të aplikohet normalisht kur temperatura e ambientit të jetë jo më pak se $+5^{\circ}\text{C}$ - $+35^{\circ}\text{C}$.

Karakteristikat teknike:

- Forma:	Pluhur
- Pesha specifike:	1.6 ± 0.2 kg/litër
- Rezistenca në përkulje	≥ 1.5 MPa (N/mm ²)
- Rezistenca në ngjeshje	≥ 4.5 MPa (N/mm ²)
- Forca në ngjitje	≥ 1.2 MPa (N/mm ²)

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij. Ky standart është i zbatueshëm për llaçet e fabrikuara të suvatimit dhe stukimit, të bëra në bazë të lidhjeve inorganike për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm në mure, tavane, kolona dhe ndarëse. Ai përmban përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

11. Plakë gipsi për ambjete të jashtme

Të jetë pllakë e tipit çimentato dhe një panel ndërtimi i fortë, i padjegshëm me përbërje bazë çimento e lidhur me rrjetë të veshur me fije qelqi të ngulitur në sipërfaqet e pasme dhe të përparme. Të ofrojë të gjitha përfitimet e një sistemi paneli të thatë. Paneli të sigurojë një bazë solide që i reziston kushteve ekstreme të motit. Të përdoret në aplikime të jashtme për mure dhe tavane si një sistem i aplikuar drejtpërdrejt (i menaxhuar nga uji) ose i venteluar. Të shërbejë gjithashtu si një nënshtresë për sistemet kompozite termoizoluese.

Karakteristikat teknike:

- Trashësia:	12 ± 1 mm
- Pesha specifike:	≥ 1000 kg/m ³
- Përçueshmëria termike:	≤ 0.4 W/mK
- Rezistenca në përkulje	≥ 5 MPa (N/mm ²)
- Rezistenca në tërheqje:	≥ 5 MPa (N/mm ²)
- Klasa e materialit ndërtimor:	jo i djegshëm

12. Plakë gipsi për ambjete të brendshme

Pllakat e gipsit për ambjete të brendshme përdoren para së gjithash si veshje një shtresore në sistemet e mureve që nuk plotësojnë ndonjë kërkesë të veçantë. E përshtatshme për forma dhe distanca të ndryshme të montimit. Të ketë stabilitet të lartë edhe për konstruksionet me një veshje të vetme shtrese pllake. Përpunim të jetë i thjeshtë. Të ketë bymim dhe tkurrje e vogël si rezultat i ndryshimeve të kushteve klimaterike.

Karakteristikat teknike:

- Trashësia:	12 ± 1 mm
- Pesha specifike:	≥ 650 kg/m ³

-
- Përçueshmëria termike: $\leq 0.3 \text{ W/mK}$
 - Rezistenca në përkulje $\geq 3 \text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
 - Rezistenca në tërheqje: $\geq 3 \text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
 - Klasa e materialit ndërtimor: jo i djegshëm

13. Grafiato

Veshje dekorative e gatshme për përdorim me bazë silikat silikoni që shërben për trajtimin e fasadave dhe sipërfaqeve të brendshme. Të jetë produkt ekologjik që bën të mundur ajrosjen e murit dhe parandalimin e mykut dhe nuk lejon plasaritjet. Të lejojë përshkueshmërinë e murit ndaj avujve. Mbyll plasaritjet e suvave me bazë çimento-gëlqere. Formon një strukturë të qëndrueshme dhe mbrojtëse ndaj agjentëve atmosferikë. Të ketë një punueshmëri dhe hapje mjaft e mirë dhe i thjeshtë për t'u aplikuar. Të jetë përshtatshëm për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mirë hidroizoluese ngjithëse dhe elastike.

Karakteristikat teknike:

- Forma: i gatshëm për përdorim
- Peshë specifike: $\geq 1.5 \text{ g/cm}^3$
- Përçueshmëria termike: $\leq 0.9 \text{ W/mK}$
- Aftësia ngjithëse $\geq 1.2 \text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Temperatura e aplikimit: $+5^\circ\text{C deri } +35^\circ\text{C}$
- Klasa e materialit ndërtimor: jo i djegshëm

14. Sistem kompozit termoizolues i jashtëm

Veshje fasade me polisterol kompakt $t = 5\text{cm} +$ rrjetë + suva në mure të jashtme me qëllim termoizolimin ndaj faktorëve atmosferikë.

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin Shqiptar SSH EN 13499:2003 Produkte për izolim termik për përdorim në ndërtesa
- Sistemet e izolimit termik të jashtëm të bazuar në polisterol të bymyer – Karakteristikat. Ky standard teknik specifikon kërkesat për produktet e prodhuara nga fabrika për sistemet e përbërë të izolimit termik të jashtëm të bazuara në polisterol me trashësi të caktuar, të dorëzuara si një komplet dhe të përdorura si izolim termik për ndërtesa. Këto produkte aplikohen në sipërfaqet e jashtme të mureve të reja ose ekzistuese dhe/ose mbulesave për të përmirësuar izolimin termik.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha materialet e tjera që do të përdoren për kryerjen e punimeve duhet të plotësojnë kushtet teknike KTZ dhe KTP dhe standartet teknike kombëtare ose ndërkombëtare për çdo produkt të pasqyruar në këtë shtojcë. Në përgjithësi cilësia për materialet e kërkuara është e detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi. Kushtet teknike të zbatimit janë të detajuara tek termat e referencës Shtojca 7. Vendodhjet e objekteve arsimore në të cilat do të kryhen punimet e kërkuara në DST sipas preventivit, gjenden brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe do të pasqyrohen në kontratë të detajuara.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

ËSHTË PARAQITUR NË SHTOJCËN BASHKANGJITUR DST

Afatet e ekzekutimit:

ËSHTË PARAQITUR NË SHTOJCËN BASHKANGJITUR DST

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike ka në administrim të gjitha objektet parashkollore, shkollore, objektet publike dhe banesat sociale në pronësi të Bashkinë Tiranë, të cilat kryejnë funksionet e tyre gjate gjithë periudhes vjetore me perjashtim te objekteve shkollore qe ne periudhen 15 qershor deri ne 1 shtator, nderpresin mesimdhënien. Gjëndja teknike e objekteve ne lidhje me cilesine e bojatisjes se mureve te brendeshme e te jashteme eshte monitoruar nga Drejtoria Teknike dhe e transportit, duke hartuar edhe nje plan veprimi vjetor per mirmbajtjen e tyre ne kete aspekt, pra nje planifikim per lysterjen e siperfaqeve te ketyre objekteve sipas nevojave.

Qëllimi i Shërbimit të lysterjes: Bojatisje, higjenizimi, pastrimi dhe ripërtëritje e ngjyrave në siperfaqet e mureve të brendëshme dhe të jashtëme të objekteve shkollore.

Objekti i Shërbimit të lysterjes: Të mundësojë lysterjen me cilësi dhe në kohë, duke përdorur bojra e materiale ekologjike dhe të standartizuara, në objektet shkollore te Bashkisë Tiranë, të siperfaqeve te mureve të brendëshëm e të jashtëm dhe tavanet, sipas listës së objekteve të sipërcituar.

Kontrata zbatohet me plane të programuara mujore duke mbajtur kontakte të përditshëm me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e procedurës së zbatimit të kontratës, procedurë me të cilin OE njihet zyrtarisht nga AK me fillimin e zbatimit.

Të gjitha materialet bojatisëse dhe të riparimit si: bojë hidroplastike inporti cilesi e larte, boje hidroplastike, boje hidromat, astar, boje vaji, boje betoni, stuko patinimi, duhet të jenë të certifikuar konform standartit (CE) dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi. Ne vijim po argumentoje specifikimet teknik te nevojshme per materialet sipas zerave te punes ne preventiv.

Detyrat:

Të realizojë në kohë, sasi e me cilësi shërbimet e planifikuara, të cilat do të kryhen cdo ditë pune, duke u kujdesur për të mos penguar kryerjen e aktivitetit shkollor Kryerjen e procesit të lysterjes se mureve te brendeshme e te jashteme, tavanet e objekteve shkollore dhe riparimet sipas nevojave reale, të përshkruara më poshtë:

Nr.	Nr. Analize	Përshkrimi i zërit të punimit	Njësia	Përshkrimi i punës
		A1 - PUNIME BOJATISJE DHE SKELERIE		
1	2.404/1	Boje hidroplastike inporti cilesi e larte, lysterje fasade	m ²	Lysterja me boje hidroplastike inporti do te behet per disa objekte shkollore ne fasaden e jashteme te ketyre institucioneve si dhe muret rrethuese te tyre. Lyrja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e murit dhe pasi te jete aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojes do te percaktohet ne moment sipas deshires se autoritetit kontraktor.
2	2.404/1	Boje hidroplastike inporti cilesi e larte, lysterje mur rrethues	m ²	

3	2.404	Boje hidroplastike, lysterje brenda	m ²	Lysterja me boje hidroplastike do te behet per siperfaqet e brendeshme te objektit te institucioneve shkollore qe kane te bejne me muret e brendeshme te tyre. Lysterja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e murit dhe pasi te jete aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojes do te percaktohet ne momentin e aplikimit, sipas deshires se autoritetit kontraktor.
4	Analize	Boje hidromat, lysterje tavane	m ²	Lysterja me boje hidromat do te behet per siperfaqet e tavaneve te institucioneve shkollore. Lysterja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e tavanit. Lysterja do te behet me boje, pa pigment, me perjashtim te ndonje rasti te vecante.
5	Analize	Boje ne siperfaqe betoni	m ²	Lysterja me boje per siperfaqe betoni do te behet ne disa objekte shkollore, ne territorin e jashtem sportiv, per te kuadratuar me nje ose me shume ngjyra fushen e basketbollit apo te voleibollit, e cila eshte kompozuar mbi terren te jashtem me bazament beton i ilustruar. Lysterja do te behet me dy duar dhe pasi te jete pastruar mire dhe aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojes do te percaktohet ne moment sipas deshires se autoritetit kontraktor.
6	Analize 152	Vijezim me boje bikomponente gjeresi 15 cm, per fushe sportive	ml	Vijezimi me boje bikomponente do te kryhet ne disa objekte shkollore, ne terrenet e jashteme sportive per te konturuar fushat e basketbollit dhe te voleibollit, te kompozuar mbi nje terren te jashtem me bazament beton te ilustruar apo asfaltobeton.
7	2.401	Boje vaji mbi siperfaqe metalike	m ²	Lysterja me boje vaji ne siperfaqe metalike, do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lysterjen me dy duar te siperfaqes se kangjellave ne murin rrethues te objektit.
8	2.403	Boje vaji mbi siperfaqe muri	m ²	Lysterja me boje vaji ne siperfaqe muri do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lysterjen me dy duar te siperfaqes se poshteme te mureve ne lartesine 1.65 m, qe eshte e ekspozuar nga prekjet dhe ferkimet gjate perdorimit te ambientit.
9	2.400	Boje vaji mbi siperfaqe druri	m ²	Lysterja me boje vaji ne siperfaqe druri do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lysterjen me dy duar te siperfaqes se stolave te instaluar ne oborr
10	2.431	Skela metalike me tubo per fasade > 12 m	m ²	Vendosja e skelave metalike do te kryhet ne ato objekte shkollore qe do te lyhen apo riparohen ne fasade.
11	2.429	Skela metalike me tubo per tavan ~ 8 m	m ²	Vendosja e skelave metalike ne ambiente te brendeshme do te behet ne ato objekte shkollore qe lartesia e ambientit i kalon 4 m ² si dhe ne kafazet e shkalleve

A2 - PUNIME SUVATIMI E VESHJE ME PLLAKA				
1	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjete+suva	m ²	Veshja e fasades me polisterol dhe shtresat perkatese do te kryhet ne disa objekte shkollore, ne fasaden e tyre, qe e kane kete shtrese te demtuar.
2	2.358/d	Veshje muri me kartonxhes çimentato	m ²	Veshje e murit te fasades me kartonxhes çimentato do te behet ne ato objekte shkollore qe kane te demtuar shtresen e veshjes me kartonxhes te fasades
3	2.297/a	Tavan me kartonxhes	m ²	Riparimi i shtreses me kartonxhes te tavanit do te kryhet ne disa tualete te objekteve shkollore, qe e kane kete shtrese te demtuar
4	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m ²	Suvatimi ne fasaden e jashteme do te behet ne ato objekte shkollore, ne vendet ku eshte prishur shtresa e suvatimi ekzistues te fasades nga lageshtira, ne zonen prane themeleve ose prane shkarkimit te ujrave prane ulluqeve.
5	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4m	m ²	Suvatimi me grafiato do te kryhet ne ato objekte shkollore, qe kane te demtuar shtresen e suvatimit ne fasade.
6	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m ²	Patinimi i murit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues.
7	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m ²	Patinimi i tavanit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues.
A3 - PUNIME TE NDRYSHME E PRISHJE				
1	60% puntori e An 2.264	Prishje veshje fasade me polisterol	m ²	Ne fasaden e disa objekteve shkollore, atje ku eshte demtuar shtresa e veshjes me polisterol, perpara procesit te zevendesimit te kesaj pjese, duhet te behet edhe prishja e kesaj shtrese te demtuar.
2	60% puntori e An 2.331	Prishje suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m ²	Ne vendet me lageshtire, ne fasaden e objektit atje ku eshte demtuar shtresa e suvatimit, perpara procesit te lyerjes duhet te behet edhe riparimi i suvatimit te demtuar. Per kete nevojitet prishja e kesaj shtrese suvatimi te demtuar.
3	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	Transporti i materialeve dhe inerteve qe jane mbledhur gjate riparimit dhe lyerjes se shtresave te objekteve shkollore, do te kryhet ne drejtim te landfillit te Sharres.
4	Analize	Depozitim mbeturinash ne landfill	ton	Largimi i materialeve inerte do te behet ne menyre te organizuar, duke i depozituar ne vendgrumbullimet e percaktuara nga Bashkia Tirane

Shpërndarja:

1) Lyerje me Boje hidroplastike importi cilesi e larte, lyerje fasade dhe mure rrethuese

Lyerja me boje hidroplastike importi do te behet per disa objekte shkollore ne fasaden e jashteme te ketyre institucioneve si dhe muret rrethuese te tyre. Lyrja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e murit dhe pasi te jete aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojës do te percaktohet ne moment sipas deshires se autoritetit kontraktor.

2) Lyerje me Boje hidroplastike per siperfaqe te brendeshme te mureve

Lyerja me boje hidroplastike do te behet per siperfaqet e brendeshme te objektit te institucioneve shkollore qe kane te bejne me muret e brendeshme te tyre. Lyrja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e murit dhe pasi te jete aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojës do te percaktohet ne momentin e aplikimit, sipas deshires se autoritetit kontraktor.

3) Lyerje me Boje hidromat per lyerje tavanet e ambienteve te brendeshme

Lyerja me boje hidromat do te behet per siperfaqet e tavanaeve te institucioneve shkollore. Lyrja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e tavanit. Lyerja do te behet me boje, pa pigment, me perjashtim te ndonje rasti te vecante.

4) Lyerje me Boje vaji mbi siperfaqe muri, metalike dhe druri

Lyerja me boje vaji ne siperfaqe metalike, do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lyerjen me dy duar te siperfaqes se kangjellave ne murin rrethues te objektit. Lyerja me boje vaji ne siperfaqe muri do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lyerjen me dy duar te siperfaqes se poshteme te mureve ne lartesine 1.65 m, qe eshte e ekspozuar nga prekjet dhe ferkimet gjate perdorimit te ambientit. Lyerja me boje vaji ne siperfaqe druri do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lyerjen me dy duar te siperfaqes se stolave te instaluar ne oborr

5) Lyerja me boje per siperfaqe betoni

Lyerja me boje per siperfaqe betoni do te behet ne disa objekte shkollore, ne territorin e jashtem sportiv, per te kuadratuar me nje ose me shume ngjyra fushen e basketbollit apo te voleibollit, e cila eshte kompozuar mbi terren te jashtem me bazament beton i ilustruar. Lyerja do te behet me dy duar dhe pasi te jete pastruar mire dhe aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojës do te percaktohet ne moment sipas deshires se autoritetit kontraktor.

6) Vijezim me boje bikomponente gjeresi 15 cm, per fushe sportive

Vijezimi me boje bikomponente do te kryhet ne disa objekte shkollore, ne terrenet e jashteme sportive per te konturuar fushat e basketbollit dhe te voleibollit, te kompozuar mbi nje terren te jashtem me bazament beton te ilustruar apo asfaltobeton.

7) Patinim i mureve dhe tavanaeve me allçi (stuko patinimi)

Patinimi i murit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues. Patinimi i tavanit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues.

8) Suva e zakonshme fasade per mur tulle dri ne lartesi h ~ 8 m

Suvatimi ne fasaden e jashteme do te behet ne ato objekte shkollore, ne vendet ku eshte prishur shtresa e suvatimi ekzistues te fasades nga lageshtira, ne zonen prane themeleve ose prane shkarkimit te ujrave prane ulluqeve.

9) Veshje muri me kartonxhes çimentato

Veshje e murit te fasades me kartonxhes çimentato do te behet ne ato objekte shkollore qe kane te demtuar shtresen e veshjes me kartonxhes te fasades

10) Tavan me kartonxhes

Riparimi i shtreses me kartonxhes te tavanit do te kryhet ne disa tualete te objekteve shkollore, qe e kane kete shtrese te demtuar

11) Plakë gipsi për ambjete të brendshme

Pllakat e gipsit për ambjete të brendshme përdoren para së gjithash si veshje një shtresore në sistemet e mureve që nuk plotësojnë ndonjë kërkesë të veçantë. E përshtatshme për forma dhe distanca të ndryshme të montimit. Të ketë stabilitet të lartë edhe për konstruksionet me një veshje të vetme shtrese pllake. Përpunim të jetë i thjeshtë. Të ketë bymim dhe tkurrje e vogël si rezultat i ndryshimeve të kushteve klimaterike.

12) Suvatim me grafiato per sipërfaqe te jashteme muri deri ne lartesi h > 4m

Suvatimi me grafiato do te kryhet ne ato objekte shkollore, qe kane te demtuar shtresen e suvatimit ne fasade.

13) Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjete+suva

Veshja e fasades me polisterol dhe shtresat perkatese do te kryhet ne disa objekte shkollore, ne fasaden e tyre, qe e kane kete shtrese te demtuar.

14) Skela metalike me tubo per fasade me lartesi mbi > 12 m

Vendosja e skelave metalike do te kryhet ne ato objekte shkollore qe do te lyhen apo riparohen ne fasade gjate gjithe perimetrit te jashtem te objektit shkollore. Montimi i tyre do t realizohet duke respektuar rregullat e sigurmit teknik.

15) Skela metalike me tubo per tavan me lartesi ~ 8 m

Vendosja e skelave metalike ne ambiente te brendeshme do te behet ne ato objekte shkollore qe lartesia e ambientit i kalon 4 m2 si dhe ne kafazet e shkalleve

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

	Objekti Arsivor		Adresa
Nr.		NJËSIA BASHKIAKE NR.1	
1	Shkolla e Mesme "Abdulla Keta"	Lyerje e brendeshme	Shkoze / Nj.B.Nr.1
2	Shkolla 9-Vjecare "Ali Demi"	Lyerje e brendeshme	Rr. Ali Demi/ Nj.B.Nr.1
3	Shkolla 9-Vjecare "1- Maji"	Lyerje e jashteme dhe e brendeshme	Rr. Ali Demi/ Nj.B.Nr.1
Nr.		NJËSIA BASHKIAKE NR.2	

1	Shkolla e Mesme "Sander Prosi"	Lyerje e jashteme dhe e brendeshme	Sauk / Nj.B.Nr.2
2	Shkolla 9-Vjecare "Fan Noli"	Lyerje e brendeshme	Rr. Qemal Stafa / Nj.B.Nr.2
3	Shkolla 9-Vjecare " Mihal Grameno"	Lyerje e brendeshme	Rr. Mihal Grameno / Nj.B.Nr.2
4	Shkolla 9-Vjecare " Hasan Tasim "	Lyerje e jashteme dhe e brendeshme	Rr. Hoxha Tasim / Nj.B.Nr.2
5	Shkolla e Baletit (Koreografike)	Lyerje e brendeshme	Rr.P.N.Luarasi / Nj.B.Nr.2
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.3		
1	Shkolla e Mesme "Andon Z.Cajupi"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Kongresi Mnanastirit/ Nj.B.Nr.3</i>
2	Shkolla 9-Vjecare " Hasan Prishtina "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Qemal Stafa/ Nj.B.Nr.3</i>
3	Shkolla 9-Vjecare "Kongresi i Lushnjes "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Qemal Stafa/ Nj.B.Nr.3</i>
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.4		
1	Shkolla 9-Vjecare " Ramazan Jarani"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Niko Avrami/ Nj.B.Nr.4</i>
2	Shkolla 9-Vjecare " Bajram Curri "	Lyerje e brendeshme	<i>Rruga e Dibres/ Nj.B.Nr.4</i>
3	Shkolla 9-Vjecare " Pal Engjell "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Reparti ushtarak 3700/ Nj.B.Nr.4</i>
4	Shkolla 9-Vjecare " Ardian Klosi "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. 5 Maji/ Nj.B.Nr.4</i>
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.5		
1	Shkolla 9-Vjecare "Edith Durham"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Sami Frasheri/ Nj.B.Nr.5</i>
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.6		
1	Shkolla 9-Vjecare "Shyqyri Peza "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Hamdi Cenoymeri /Nj.B.Nr.6</i>
2	Shkolla 9-Vjecare " Betim Muco "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Llazi Miho / Nj.B.Nr.6</i>
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.7		
1	Shkolla e Mesme "Arben Broci"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Besim Imami/ Nj.B.Nr.7</i>
2	Shkolla 9-Vjecare "Naim Frasheri "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Frosina Plaku/ Nj.B.Nr.7</i>
3	Shkolla 9-Vjecare "Pjeter Budi "	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Myslym Shyri/ Nj.B.Nr.7</i>
4	Shkolla 9-Vjecare "Dhora Leka "	Lyerje e brendeshme dhe e jashteme	<i>Fusha e Aviacionit/ Nj.B.Nr.7</i>
Nr.	NJËSIA BASHKIAKE NR.8		
1	Shkolla 9-Vjecare "Misto Mame"	Lyerje e brendeshme	<i>Rruga e Dibres /Nj.B.Nr.8</i>

2	Shkolla 9-Vjecare "Siri Kodra"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Siri Kodra/Nj.B.Nr.8</i>
<i>Nr.</i>		NJËSIA BASHKIAKE NR.9	
1	Shkolla 9-Vjecare "Lidhja e Prizrenit"	Lyerje e brendeshme	<i>Rruga e Barikadave/Nj.B.Nr.9</i>
<i>Nr.</i>		NJËSIA BASHKIAKE NR.10	
1	Shkolla e Mesme "Qemal Stafa"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Kongresi i Permetit /Nj.B.Nr.10</i>
2	Shkolla e Mesme "Kristoforidhi"	Lyerje e brendeshme dhe e jashteme	<i>Rr. Shyqyri Bexholli/Nj.B.Nr.10</i>
3	Shkolla 9-Vjecare "Konferenca e Pezes"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Him Kollit /Nj.B.Nr.10</i>
<i>Nr.</i>		NJËSIA BASHKIAKE NR.11	
1	Shkolla 9-Vjecare "28-Nentor"	Lyerje e brendeshme	<i>Rr. Pandi Dardha /Nj.B.Nr.11</i>
2	Shkolla 9-Vjecare "Isa Boletini"	Lyerje e brendeshme dhe e jashteme	<i>Kamez/Nj.B.Nr.11</i>

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha materialet e tjera që do të përdoren për kryerjen e punimeve duhet të plotësojnë kushtet teknike KTZ dhe KTP dhe standartet teknike kombëtare ose ndërkombëtare për çdo produkt të pasqyruar në këtë shtojcë. Në përgjithësi cilësia për materialet e kërkuara është e detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi.

Vendi dhe afati i kryerjes së shërbimeve:

Vendodhjet e objekteve arsimore në të cilat do të kryhen punimet e kërkuara sipas preventivit, gjenden brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Keto objekte shkollore, sipas tabelës së mësipërme, janë parashikuar për kryerjen e shërbimit sipas zerave të punimeve të percaktuara në preventiv. Ndërhyrja në to do të realizohet sipas planit mujor të ekzekutimit të shërbimeve të miratuar nga autoriteti kontraktor.

Afati i kryerjes të shërbimit të përllëgaritur: Nga data 1 Qershor 2022 deri më 15 Shtator 2022, i kryer deri në 91 ditë pune nga fillimi i kryerjes së shërbimit, duke përllëgaritur ditët e Djela pushim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale;
- NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS - 4 A Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to etj.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/I N. 25.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të certifikuar nga organet tatimore (nëse nuk është certifikuar bilanci i Vitit 2021, të dorëzohen bilancet e viteve 2019 dhe 2020). Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. (nëse nuk është certifikuar bilanci i Vitit 2021, të dorëzohen xhirot vjetore të viteve 2019 dhe 2020). Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2021 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.
- 1 (një) Arkitekt.

Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 120 (njëqind e njëzet) punonjësve për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës bojaxhi;
- ❖ 4 (katër) punonjës muratorë/specialist ndërtimi;
- ❖ 2 (dy) punonjës suvatues;
- ❖ 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi.
- ❖ 1 (një) punonjës specialist për punime gipsi.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

